



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:159093

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05634378

KE.nr.107/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “DUKAGJINI” Sh.A., me numër të biznesit 70260736, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Nexhmedin Demolli me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës me numër të biznesit 70533299, me seli në sheshin “Nëna Terezë” Prishtinë, objekt kontesti rimbursim dëmi, vlera e kontestit 111,500.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 19.04.2024, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurit, me datën 29.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.A., dhe DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës, që në emër të rimbursimit të mjeteve të paguara, si pasojë e dëmeve të shkaktuara si pasojë e zjarrit të ndodhur më datën 25.12.2006 në objektin e NTPSH KU&BA, të ia paguaj paditëses shumën prej 111,500.00€ (një qind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind euro) me kamatë ligjore në lartësi prej 8% të interesit vjetor, nga data e paraqitjes së padisë 28.08.2017, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- II. DETYROHET i padituri që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 3.205,00 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.A., me datën 28.08.2017, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) për rimbursimin e dëmit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që nga rasti i siguruar i policës kasko, me numër protokollit 9106 e datës 17.08.2006, të ia rimbursoj paditësit mjetet e paguara të përfituesit nga paditësi, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga zjarri i datës 25.12.2006, e të cilat janë shkaktuar nga ana e të paditurës, në shumë prej 111,500.00€ me kamatë ligjore në lartësi prej 8% të interesit vjetor, duke filluar nga data e pagesës 01.09.2016 e deri në përmbushjen e detyrimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë

Përfaqësuesi i paditësit në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se me datën 16.06.2016 përmes vendimit të Bankës Qendrore numër 31-14/2016, është ndryshuar emërtimi i paditëses nga Kompania e Sigurimeve “Croatia Sigurimi” Sh.a në Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.a, më tej ka shtuar se me datën 25.12.2006 në objektin e NTPSH “Ku&BA” ka ndodhur ndezja e zjarrit nga i cili janë shkaktuar dëme në objektin dhe mallin e të siguruarit të paditësit, pasi që i njëjti ka poseduar policë valide të sigurimit të pronës të lidhur me “Croatia Sigurimi” Sh.A, me numër të policës 9106 e datës 17.08.2006 për sigurim të pronës në vlerë deri në shumën prej 175,000.00 euro, pas ndodhjes së rastit i siguruari ka paraqitur kërkesë për kompensim dëmi, meqenëse palët nuk kanë arritur marrëveshje në procedurë administrative, i njëjti i është drejtuar gjykatës me padi duke kërkuar që nga e paditura e parë Kompania e Sigurimeve vlerën prej 175.000,00 euro ndërsa nga e paditura e dytë Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a shumën prej 333,300.00 euro, pas pranimit të Aktgjykimit III.C.nr.285/11 i datës 03.10.2014 siguruari këtu paditësi ka arritur marrëveshje me kompaninë NTPSH “Ku&BA” me të cilën kanë arritur pajtim që kontestin ta zgjidhin me marrëveshje jashtëgjyqësore ashtu që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga zjarri i datës 25.12.2006 paditësja ti kompensoj shumën prej 110.000,00 euro si dhe shumën prej 1,500.00 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore. Me arritjen e kësaj marrëveshje edhe ekzekutimin e pagesës këtu paditësi ka përmbushur detyrimin e tije ndaj të dëmtuarit NTPSH “Ku&BA” dhe i njëjti ka marr për obligim që me parashtresë të njoftoj gjykatën e apelit për tërheqjen e padisë ndaj KS Croatia Sigurimi, me tej ka theksuar se në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se deri të ndodhja e zjarrit ka ardhur për shkak të lëshimeve të

KEK-ut, ndërsa paditësi në bazë të policës së sigurimit e cila ishte valide në atë kohë ka bërë kompensimin e dëmit të pësuar nga i dëmtuari, dhe nga të cekurat rrjedhë e drejta e paditësit për rimbushim nga i padituri për shumën e paguar ndaj të dëmtuarit – të siguruarit. Ndërsa gjatë seancave ka deklaruar se në tërësi si në padi dhe kërkesë padi dhe parashtrësive të dorëzuara me prova materiale nga të cilat prova të siguruara gjatë procedurës gjyqësore është vërtetuar shkaktari i zjarrit dhe dëmit të shkaktuar në objektin e të dëmtuarit, baza juridike si dhe lartësia e dëmit është vërtetuar me prova materiale. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar pas administrimit të provave është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadsisë si dhe lartësia e saj, nga vendimi i shkallës së parë, të Apelit dhe Gjykatës Supreme me numër E.Rep. nr. 9/2022, vendime të cilat janë konsideruar si çështje paraprake ku me këto vendime në mënyrë decitive i u është dhënë e drejta të paditurës se parë tani paditësit që ti rekresojë mjetet e paguara nga shkaku i zjarrit të KEK-u, nga vendimi i Gjykatës Supreme paditësit i takon e drejta e regresit për mjetet e paguara, e drejtë e cila buron nga dispozitat ligjore në fuqi, prandaj gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi kërkesën paditësit si të bazuar, shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, për faktin se e paditura me paditësen nuk ka as një raport kontraktual dhe nuk ka as një arsye ligjore për rimbursim për dëmin e paguar, dhe mbi këtë bazë i mungon edhe legjitimiteti real pasivë, për më tej me as një vendim e paditura nuk është shpallur përgjegjëse për shkaktimin e ndonjë dëmi eventual, ashtu që kontrata e lidhur mes paditësit dhe personave të tretë si dhe kompensimi mbi këtë bazë nuk ka as një impakt të e paditura, dhe nuk mund të shërbej si arsye për rimbursim. Për më tej Aktgjykimi i shkallës së parë të cilit i është referuar paditësi nuk është aktgjykim i plotfuqishëm i njëjti është anuluar dhe abroguar sipas Aktgjykimeve të shkallës së dytë dhe të tretë, më tej ka shtuar se LMD-ja përcakton saktë rastet e rimbursimit mbi bazën e shkaktimit të dëmit andaj padia e paditësit nuk ka bazë ligjor. Gjatë seancave gjyqësore ka deklaruar edhe më tej pranë përgjegjëse në padi dhe deklarimeve lidhur me këtë proces gjyqësor, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme me numër E.ref.nr.9/22, lidhur me kërkesën për kompensimin e demit nga Ku&Ba në raport me KEK-un e njëjta është refuzuar në tërësi si e pa bazuar. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara vërtetohet që në këtë çështje sa i përket rimbursimit është në tërësi kërkesë e pa bazuar, ndërsa sa i përket vërtetimit të përgjithësisë konsiderojmë se është kërkesë e parashkruar për faktin se në çështjen paraprake nuk ka pasur fare siguri të provës ashtu siç parashihet me ligjin e

procedurës kontestimore, ku me prezencën e gjykatës do të vërtetohej shkaktimi i demit, gjithashtu në këtë rast nuk ka pasur asnjë procedure penale, i cili do të paraprinte çështjes në mes biznesit Kuba dhe subjektit KEK sh.a, ndërsa me vendime gjyqësore si ajo e Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje ekonomike, Gjykatës së Apelit dhe ajo e Supremes, në diapozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë dhe Supremes nuk është vërtetuar se KEK është shkaktar për demin ndaj apo në biznesin Kuba, sikurse në atë procedure të ishte një vendim gjyqësor meritor për shkaktarin e demit, atëherë konsiderojmë që në këtë çështje me të drejtë paditësja Kompania e Sigurimit do të mund të lindte e drejta e regresit pas përmbushjes me kontratën siç është cituar më lartë, ndërsa tani provat e propozuar si ato ekspertizat, sipas vendimeve të gjykatave të cituara më lartë, nuk janë trajtuar fare lidhur me besimin ndaj tyre, andaj e paditura KEK konsideron që padia dhe kërkesëpadia e paditëses lidhur me rimbursimin sipas precizimit më lartë është tërësisht e pa bazuar pasi që me asnjë vendim gjyqësor nuk është vërtetuar përgjegjësia lidhur me biznesin Kuba, shpenzime lidhur me këtë procedure nuk kërkojmë.

I ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat materiale të propozuara nga palët dhe bëri leximin e këtyre provave: Marrëveshja jashtëgjyqësore nr.389 e datës 01.09.2016, e lidhur ndërmjet NTPSH Ku&Ba dhe K.S Dukagjini; transferi bankar, i datës 01.09.2016; Vendimi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me numër 31-14/2016, i datës 16.06.2016 ; Ekspertiza financiare, e punuar nga eksperti R.B., e datës 02.04.2013; Raporti i Superekspertizës nr.162/14, e datës 01.04.2014, e punuar nga Prof.Dr. A.G., Prof.Dr. R.S. dhe Dr. Kandidat G.L.; Ekspertiza Elektrike e punuar nga grupi i eksperteve A.M., R.H. dhe M.Sh., Maj 2019

Gjykata pas vlerësimit të provave dhe deklarimeve të palëve të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe gjeti se:

Në rastin konkret rezulton se për asnjërën palë ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se NTPSH Ku&Ba ishte e siguruar tek paditësja me sigurim vullnetar kasko.

Po ashtu nuk është kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse se gjatë periudhës siguroese me datën 25.12.2006, në fshatin Shkabaj ka ndodhur ndezja e zjarrit në objektin e NTPSH

Ku&Ba si dhe fakti që paditësja e ka kompensuar dëmin e shkaktuar nga zjarri në vlerë prej 111.500,00 euro, në objektin e siguruar sipas sigurimit vullnetar kasko.

Në rastin konkret, kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte nëse e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit, respektivisht rimbursimin e paditësit për shumën e paguar në emër të kompensimit të dëmit.

Nga leximi i vendimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me numër 31-14/2016, i datës 16.06.2016, është konstatuar se është ndryshuar emërtimi i Kompanisë së Sigurimeve “Croatia Sigurimi” Sh.A., në Kompaninë e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.A.

Nga raporti i super ekspertizës e përpiluar nga Prof. A.G., Prof. R.S. dhe Dr. Kandidat G.L. e datës 01.04.2014 është konstatuar se shkaktar i drejtpërdrejt i paraqitjes së zjarrit në objektin e NTPSH Ku&Ba, në fshatin Shkabaj Komuna Obiliq, ishte rryma elektrike, përkatësisht lidhja e shkurtër në linjën furnizuese të rrjetit elektrike që është aset i të paditurës KEK, përcjellë me valën e mbi tensioneve elektrike që ka shkaktuar paraqitja e zjarrit në KSHE_KR dhe në kabllon e qarkut që lidhjet me disselgjeneratorin ku ka shpërthyer zjari nismëtar duke shtuar se pa mëdyshje qëndron baza shkencore.

Nga Ekspertiza Elektrike e punuar nga grupi i eksperteve A.M., R.H. dhe M.Sh., e datës Maj 2019 është konstatuar se zjarri i shkaktuar është si pasojë e rrymës elektrike, defektet e pa pranuar në linjën elektrike si dhe në mbrojtje, mundësuan që përçuesit e linjës të bashkohen e si rezultat erdhi deri te shkëputja e pëçusit neutral (zero) afër shtyllës fundore me çrastë u krijuan mbtensione të cilat reflektuan në pëlcitjen e poçeve elektrike në NTPSH Ku&Ba, (dhe në mobilierinë Blakçori comere). Zjarri shpërtheu në kuadrin e shpërndarës elektrikë kryesor (KSHE KR) pastaj u përcoll edhe në kabllot tjera por edhe në kabllon furnizuese për në gjenerator, djegia e kabllave shoqërohej me krisma ku pas një kohe të shkurtër flaka përfshi tërë hapësirën e objektit.

Raporti i super ekspertizës dhe ekspertizës elektrike si provë janë dorëzuar meqenëse të njëjta janë siguruar në procedurën kontestimore të paditësit NTPSH Ku&Ba, ndaj të paditurve KS Dukagjini dhe KEK-u të udhëhequr në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Ekonomike, këto prova në këtë procedurë janë administruar ndaj të njëjtave palët nuk kanë pasur vërejtje e as pyetje ndaj ekspertëve, gjithashtu gjykata nuk ka pasur pyetje ndaj ekspertëve.

Duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të cilave gjykata ia fali besimin meqenëse ekspertizat janë punuar në mënyrë profesionale dhe të mbështetur në provat tjera të lëndës, si dhe nga të dy ekspertiza si në arsyetim ashtu edhe në përfundimin e tyre janë koherente me njëra tjetrën nuk ka pasur dallime por të dyja kanë dhënë konstatime dhe përfundime të njëjta lidhur me shkaktarin e zjarrit, andaj gjykata ka ardhur në përfundimin se shkaktimi i zjarrit të datës 25.12.2006, ishte rryma elektrike përkatësisht lidhja e shkurtër e linjës furnizuese të rrjetit elektrikë e cila është aset i KEK-ut, rezulton se e njëjta është përgjegjëse edhe për kompensimin e dëmit, respektivisht rimbursimin e paditësit për shumën e paguar në emër të kompensimit të dëmit në vlerën prej 111,500.00 €.

Gjykatë duke u bazuar në dispozitat e nenit 281 të LMD-së, i cili përcakton se “*Kur detyrimin e përmbush personi i cili ka ndonjë interes juridik në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, në bazë të vet ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore.*”, nenit 960 të LMD-së, i cili përcakton se “*Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin*”,

Gjykata, gjeti se në rastin konkret përgjegjës për kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasoj e zjarrit të datës 25.12.2006 është e paditura, si pasoj është krijuar detyrimi i të paditurës për regresim, pasi që paditësi ia ka paguar të siguruarit të tij kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit, të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar këtu te paditësi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, meqenëse nga gjendja faktike e vërtetuar rezulton se i padituri është përgjegjës për pagesën e shumës të cilën paditësi ia ka paguar të siguruarit të tij.

Lartësinë e shumës së gjykuar në shumën prej 111,500.00 €, gjykata e përcaktoi duke u bazuar në marrëveshjen jashtëgjyqësore nr.389 e datës 01.09.2016, e lidhur ndërmjet NTPSH Ku&Ba dhe K.S Dukagjini si dhe transferi bankar, i datës 01.09.2016, sipas të cilëve është vërtetuar se paditësi për kompensimin e dëmit të shkaktuar më datën 25.12.2006 të siguruarit të tij NTËSH Ku&Ba i ka paguar shumën prej 111.500,00 €

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e palës së paditur se ne çështjen paraprake nuk ka pasur fare sigurim te provës ashtu siç parashihet me ligjin e procedurës kontestimore, ku me prezencën e gjykatës do të vërtetohej shkaktimi i demit, gjithashtu ne këtë rast nuk ka pasur asnjë procedure penale, i cili do ti paraprinte çështjes ne mes biznesit Kuba dhe subjektit KEK sh.a,

ndërsa me vendime gjyqësore si ajo e Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje ekonomike, Gjykatës së Apelit dhe ajo e Supremes, në diapozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë dhe Supremes nuk është vërtetuar se KEK është shkaktare për demin ndaj apo në biznesin Ku&Ba, mirëpo erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i pabazuar, për shkak se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga Raporti i Super ekspertizës nr.162/14, e datës 01.04.2014, e punuar nga Prof. A.G., Prof. R.S. dhe Dr. Kandidat G.L.; Ekspertiza Elektrike e punuar nga grupi i eksperteve A.M., R.H. dhe M.Sh., Maj 2019, është konstatuar që shkak i zjarrit është si pasojë e lëshimeve të aseteve në pronë të KEK-ut. Për më tej pas pranimit të Aktgjykimit të III.C.nr285/2011 i datës 03.10.2014 me të cilin janë detyruar të paditurit KS Croatia Sigurim dhe KEK-u që ti kompensojnë dëmin paditësit KU&BA për shkak të zjarrit të ndodhur më datën 25.12.2006, këtu paditësja KS Dukagjini ka lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore me të siguruarin e sajë mbi bazën e policës vullnetare kasko dhe atë shumë prej 110.000,00 euro për dëmin material si dhe shumë prej 1.500,00 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe me çrraste është përmbushur në tërësi kërkesa e paditësit për dëmin e shkaktuar nga zjarri më datën 25.12.2006. Gjykata e Apelit të Kosovës në vendimin Ae.nr.188/20 të datës 25.11.2021 e ka aprovuar si të themeltë ankesën e KEK-ut dhe e ka ndryshuar vendimin ashtu që e ka refuzuar në tërësi kërkesë padinë e paditësit NTSH Ku&Ba, pasi që kërkesa e tijë është përmbushu sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore nga e paditura e parë që ishte KS Dukagjini, vendimin e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe Gjykata Supreme e Kosovës me vendimin nr. E.Rev.nr9/2022 të datës 24.01.2023, si rrjedhojë e këtyre konstatimeve dhe bazës ligjore të cekur më lartë paditësit i derivon e drejta për rimbursimin e dëmit të paguar.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimet e të paditurit edhe provat tjera të administruara lidhur me këtë çështje juridike, mirëpo ka gjetur se të njëjtat nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje juridike

Gjykata duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, e miratoi kamatëvonesën e kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç shumës në emër të kompensimit - rimbursimit, paditësit t’ia paguajë edhe kamatën ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 28.08.2017 e deri në pagesën definitive.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së, duke ia njohur paditësit shpenzimet dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 325.00 €, për përfaqësim në tri seanca të shtyra në shumë prej 633.00 € (3 x 211), për përfaqësim në 4 seanca

shumën prej 1.690,00 € (4 x422.50€) për taksën gjyqësore shumën për padi shumën prej 557.00 €, në shumë të përgjithshme prej 3.205,00 €

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.107/22, datë 29.04.2024.

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.